



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS EITI
SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENÇË
NË INDUSTRIJË NXJERRËSE
EITI SHQIPËRI**

VENDIM

Nr. 3, datë 21. 06. 2018

Grupi Ndërinstitucional i Punës EITI i ngarkuar me zbatimin e aktivitetit EITI në Shqipëri, pasi u njoh dhe diskutoi në Mbledhjen MSG-së së datës 21 Qershor 2018, Termat e Referencës/ ToRs për Administratorin e Pavarur që do të përgatisë Raportin EITI 2017, Termat e Referencës/ToRs për Paketën e Komunikimit për vitin 2018-2019, pasi u njoh dhe diskutoi Raportin e Progresit Vjetor të Aktiviteteve për vitin 2017, vijoi me marrjen e Vendimeve të mëposhtme.

Për sa më sipër, Grupi Ndërinstitucional i Punës EITI Shqipëri,

VENDOSI

Për Raportin EITI 2017 do të raportojnë:

- Të gjitha Kompanitë aktive të Hidrokarbureve (prodhimi dhe kërkimi) (10 kompani).
- Përsa i përket sektorit të prodhimit të hidro-energjisë, MSG-ja ka rënë dakort që 15 kompanitë më të mëdha që operojnë në këtë sektor (rreth 91% e prodhimit të energjisë) do të mbulohet nga Raporti EITI 2017.
- Përsa i përket sektorit minerar, 138 kompani minerare të cilat mbulojnë përafërsisht 91% të prodhimit total.
- Në mënyrë që të sigurohet një proces rakordimi i arsyeshëm, MSG-ja vendosi që kompanitë e sektorit minerar që do të marrin pjesë në Raportin EITI 2017 do të jenë gjithë kompanitë me të ardhura vjetore > USD 150,000 (xhiroja e tyre financiare dhe pagesat do të maten në raport me mesataren përkatëse të vitit 2017). Ato do të përfshihen nga Administratori i Pavarur në Raportin EITI 2017.



- Në total Raporti EITI 2017 do të mbulojë:
 - a) Të dhëna të marra nga 8 agjenci shtetërore;
 - b) 15 lloje pagesash të bëra nga rreth 163 kompani dhe agjenci të tjera shtetërore ose qeverisje lokale;
 - c) 10 kompani nga sektori hidrokarbur; (100 % e Sektorit),
 - d) 15 kompani nga sektori i hidro-energjisë; (91 % e Sektorit),
 - e) 138 kompani nga sektori minerar (91 % e Sektorit),

Ngarkohet Sekretariati Shqiptar EITI për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri.

Enis ALIKO

Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

KRYETAR

Grupi Ndërinstitucional i Punës EITI Shqipëri

